



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 1608/<sub>1</sub> prot.

Gramsh, më 22/05/2020

VENDIM  
Nr. 94 Datë. 20/04/2020

**PËR DHËNIE SHPËRBLIMI NGA FONDI REZERVË PËR PËRBALLIMIN  
E SHPENZIMEVE PËR KURIMIN ME TERAPI INTESIVE**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës datë 20.05.2020 pasi mori në shqyrtim, kërkesën e paraqitur nga **Z. Sokol Idriz Murati** datëlindja **17/11/1971** babai i dy fëmijëve minore, ka sjellë kërkesë për ndihmë financiare, sipas dokumenteve në dosjen e këshillit, i diagnostikuar për herë të dytë brenda dy vitesh me sëmundje të keqe (kancer) në organet jetësore, sipas dokumentave mjeksorë duhet të vazhdojë për herë të dytë terapinë me kimio. Këshilli diskutoj për miratimin e përdorimit të pjesshëm nga fondi rezervë të planit të buxhetit 2020, mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji 9936 datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të ligjit 10296 datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ligjin 109 datë 30/10/2017 “Për buxhetin e vitit 2018” si dhe ligjin 139 datë 17/12/2015 “Për vetqeversijen vendore” neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 gërma “b” neni 54 gërma “dh”;

**VENDOSI:**

- 1- Dhënie e masës së shpërblimit 50.000 (pesëdhjet mijë) lekë, nga fondi rezervë për **Z. Sokol Idriz Murati**
- 2- Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Endri Mema**

Konceptoi: E.Mema  
Miratoi: G.Lena  
Konfirmoi: G.Lena



**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Greta Lena**